



# BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMERISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14 Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

JANAR, 2020

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin janar 2020 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

## 1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit janar 2020, zënë 26 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 187.81/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 4.39/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike, dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin janar 2020, me incidencë 0.9/10.000 banorë (15 raste të konfirmuara), 3 raste në Korçë (0.24/10.000 banorë) dhe Tirana vetëm 1 rast me Salmonelozë jotifoide. Të gjitha rastet janë konfirmuara në laboratorin e rrethit përkatës.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin janar 2020, në nivel kombëtar, përkatësisht me incidencë 0.72/10.000 banorë (12 raste të konfirmuara), Kruja 2 raste, Lezha dhe Tirana kanë raportuar përkatësisht vetëm nga 1 rast të konfirmuar me Shigelozë.

Gjatë muajit janar është raportuar një rast i dyshuar i grup-moshës 40-44 vjeç me Tifo abdominale, nga rrethi i Krujës. Janë marrë kampione uji të pijshëm në vatër dhe në zonën përreth të cilat kanë rezultuar brenda normave, si nga ana fiziko-kimike dhe mikrobiologjike. Koprokulturat e personave të kontaktit kanë rezultuar negativ.

**Tabela 1: Frekuencat dhe incidentat e sëmundjeve diarreike për muajin janar, 2020**  
(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste Janar 2020	Incidenca janar 2020 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.04
Salmoneloza	19	0.68
Shigelozë (Disenteri bacilare)	16	0.57
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	123	4.39
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	5100	182.13
Sëmundje diarreike në total	5259	187.81


## 2. Sëmundjet EPI

### 2.1. Fruthi

Gjatë muajit janar 2020 janë testuar në total 11 raste me fruth, nga të cilat janë konfirmuar 2 (18%) raste nga ana laboratorike. Këto 2 raste i përkasin bashkisë Tepelenë dhe Shkodër. Të dyja rastet janë në moshë pediatrike, të pavaksinuar dhe të shtruar në spital. Për të dyja rastet është kryer hetimi, dhe janë vaksinuar të gjitha kontaktet e ngushta.

Krahasuar me një vit më parë (grafiku1), ka një rënie të theksuar të numrit të të dyshuarve me fruth. Kështu, gjatë muajit janar 2019, në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 130 raste prej të cilave

janë konfirmuar me IgM pozitiv 65 raste. Nga këto, 39 (60%) raste i përkasin rrethit të Tiranës. 40 % e rasteve të konfirmuara i përkasin kryesisht grup-moshës < 2 vjeç (26 raste).



**Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, janar 2019**

## 2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit janar 2020 janë raportuar 12 raste me Tuberkuloz pulmonar, 3 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar dhe 9 raste me Tuberkuloz pulmonar. Rastet e raportuara me tuberkuloz pulmonar janë përkatësisht 3 nga Tirana, 2 nga Kruja dhe nga 1 rast kanë raportuar Durrësi, Librazhdi, Lushnja dhe Mirdita. Rastet janë të grup-moshave të ndryshme nga 20-65 + vjeç.

Rastet e raportuara me Tuberkuloz ekstrapulmonar janë përkatësisht 2 nga Tirana dhe 1 nga Shkodra, të grup-moshave 20-24 vjeç, 60-64 vjeç dhe 65 + vjeç.

### 3. Zoonozat

Gjatë muajit janar 2020, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14 Sh nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) Devoll dhe Librazhd janë raportuar 2 raste me antraks të grup-moshës 55-59 vjeç dhe 60-64 vjeç.

Gjatë muajit janar 2020 kemi patur 2 raste të raportuara në të gjithë vendin të konfirmuara me leptospirozë (0.07/100.000 banorë). Përkatësisht nga 1 rast kanë raportuar NJVKSH-të Fier dhe Devoll. Një rast është konfirmuar në laboratorin e ISHP-së. Nëse do ta krahasojmë me muajin paraardhës, vëmë re një rënie të numrit të rasteve për shkak të periudhës së sëmundjes, pavarësisht shtrirjes gjithëvjetore të saj, leptospiroza po paraqitet si një ndër zoonozat më problematike në raport me zoonozat e tjera.

Nga NJVKSH-të Kolonjë, Librazhd dhe Tiranë janë raportuar përkatësisht nga 1 rast me Brucelozë, gjatë muajit janar 2020 (0.11/100.000 banorë). Dy raste janë të dyshuara dhe 1 rast është i konfirmuar.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në janar 2020  
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste Janar 2020	Incidenca janar 2020 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	2	0.07
Brucelozë	3	0.11
Leptospirozë	2	0.07
Leishmaniaza viscerale	1	0.04
Leishmaniaza kutane	0	0

### 4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit janar 2020 janë raportuar në total 5 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.18/100.000 banorë) nga të cilat, 1 rast është Hepatit viral i paspecifikuar, 1 rast Hepatit viral A i konfirmuar nga Elbasani dhe 3 raste Hepatite virale B të konfirmuara nga Kuçova dhe Lushnja (2 raste).

## 5. HIV/AIDS

Gjatë muajit janar 2020 janë kryer gjithsej 82 ekzaminime për HIV, 50 meshkuj dhe 32 femra, prej të cilave 9 raste kanë rezultuar HIV pozitiv. Shpërndarja sipas gjinisë tregon se të 9 rastet janë meshkuj. Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv janë në Ballsh, Korçë, Durrës, Shkodër dhe Tiranë. Grup-mosha e rasteve pozitive varion nga 23 vjeç deri në 66 vjeç. Rastet pozitive kanë ardhur kryesisht nga Spitali i Sëmundjeve të Mushkërive, nga VCT Tiranë, nga Banka e gjakut etj.

## 6. Gripi

Nga të dhënat e raportimit sipas Survejancës së Infeksioneve Akute Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme të sistemit ALERT, Survejancës Sentinel të Sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe Survejancës së Infeksioneve Respiratore Akute të Rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se në muajin janar 2020 aktiviteti i tyre paraqet rritje, ndërsa aktiviteti i gripit ishte i përhapur dhe me intensitet shumë të lartë me qarkullim të viruseve të tipit A dhe B, me mbizotërim të virusit të tipit A, nëntipi A/H1 pdm09

INSTITUTI I  
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI